

# SHOQATA E MATEMATIKANËVE TË KOSOVËS

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/22 për Regjistrimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare në Kosovë, Kuvendi Themelues i Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur në Prishtinë, më 22 gusht 2008, miraton këtë

## STATUT

### I. Dispozitat e përgjithshme

#### **NENI 1.**

Statuti rregullon organizimin dhe funksionimin e Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës.

#### **NENI 2.**

Emri i organizatës është Shoqata e Matematikanëve të Kosovës. Në gjuhën angleze organizata quhet Kosovar Mathematical Society. Akronimi i organizatës është KMS.

#### **NENI 3.**

Shoqata e Matematikanëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme “Shoqata”) është organizatë joqeveritare dhe joprofitabile.

#### **NENI 4.**

Selia e Shoqatës është në Prishtinë. Shoqata e ka vulën e vet, në formë rrethore me diamtër 30mm, dhe logon në të cilat shkruhet: Shoqata e Matematikanëve të Kosovës 2008 Kosovar Mathematical Society. Shoqata e ka llogarinë bankare.

#### **NENI 5.**

Shoqatën e përfaqëson kryetari i Shoqatës ose anëtari i Këshillit Drejtues i cili është i autorizuar nga kryetari.

#### **NENI 6.**

Puna e Shoqatës është publike.

#### **NENI 7.**

Shoqata nuk diskriminon në asnjë pjesë të organizimit ose funksionimit të saj. Shoqata ofron mundësi të barabarta për të gjithë anëtarët dhe bashkëpunëtorët e vet pa dallim gjinie, race, religjioni, përkatësie etnike, gjuhe, moshe, apo bindjesh politike.

#### **NENI 8.**

Përdorimi i gjinisë mashkullore për termet “anëtar”, “kryetar”, “kandidat”, etj., nuk është diskriminues dhe i referohet njësoj edhe gjinisë femërore.

## II. Qëllimi dhe veprimtaria

### NENI 9.

Qëllimi i Shoqatës është avancimi i kapaciteteve ekzistuese dhe ngritja e kapaciteteve të reja për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe pedagogjike në fushën e matematikës së pastër dhe të zbatuar.

### NENI 10.

Për të arritur qëllimin nga Neni 9, Shoqata merret me veprimtaritë e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në këto:

- (a) Organizimin dhe mbështetjen e seminareve, konferencave, forumeve apo formave të tjera të organizimeve publike;
- (b) Publikimin dhe blerjen e revistave, librave, e materialeve të tjera shkencore e profesionale;
- (c) Bashkëpunimin e nevojshëm me organizmat, shoqatat, institucionet, dhe individët brenda dhe jashtë vendit;
- (ç) Organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme (si, p.sh., gara, shkolla sezonale, seri kursesh etj.) për të rinjtë e interesuar për matematikë;
- (d) Organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme (si, p.sh., seri kursesh ose ligjeratash) për mësime të mësimdhënësive, për avancimin e cilësisë në mësimdhënje.

## III. Anëtarësimi në Shoqatë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve

### NENI 11.

- 11.1. Anëtarësimi në Shoqatë është vullnetar.
- 11.2. Anëtari i Shoqatës është Anëtar i rregullt ose Anëtar Nderi.
- 11.3. Anëtar i rregullt i Shoqatës mund të bëhet personi i cili:
  - (a) Ka gradën shkencore të doktorit në shkenca matematike, ose
  - (b) Jep apo ka dhënë mësim nga shkenca matematike në ndonjë universitet brenda ose jashtë Kosovës, ose
  - (c) Jep apo ka dhënë mësim nga shkenca matematike në ndonjë shkollë të mesme të ulët ose të lartë të Kosovës, ose
  - (ç) Ka mbaruar studimet e larta (diplomë, bachelor, dyvjeçare) në shkenca matematike, ose
  - (d) Është entuziast i shkencave matematike.
- 11.4. Anëtar Nderi i Shoqatës mund të bëhet personi i cili ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për Shoqatën apo për matematikën.
- 11.5. Personi i cili dëshiron të bëhet anëtar i rregullt duhet ta dorëzojë, në Këshillin Drejtues, kërkesën për anëtarësim.
- 11.6. Kryetari ose një e treta e anëtarëve të Shoqatës mund t'i propozojë Kuvendit shpalljen e një personi Anëtar Nderi të Shoqatës. Personi i propozuar shpallet Anëtar Nderi nëse këtë e miraton shumica e anëtarëve të pranishëm në Kuvend.

## **NENI 12.**

- 12.1. Beneficionet e anëtarëve (si, p.sh., çasje me lirim ose gratis në revista ose materiale të tjera shkencore, regjistrim me lirim ose gratis në konferenca shkencore, etj.) do të përcaktohen nga Këshilli Drejtues.
- 12.2. Çdo anëtar i rregullt e jep kontributin financiar vjetor (anëtarësinë), kuotën e të cilit e cakton Këshilli Drejtues. Studentët dhe pensionistët nuk janë të obliguar ta paguajnë anëtarësinë, por mund ta bëjnë këtë me vetëdëshirë.

## **NENI 13.**

- 13.1. Anëtarësimi i një personi në Shoqatë përfundon:
  - (a) Me kërkesën me shkrim të anëtarit, ose
  - (b) Kur nuk paguan kontributin financiar vjetor, një vit pasi të jetë kërkuar nga Këshilli Drejtues, ose
  - (c) Kur përjashtohet nga Shoqata.
- 13.2. Anëtari suspendohet ose përjashtohet nga Shoqata në rastin e keqpërdorimit të pasurisë së Shoqatës, pengimit të funksionimit të Shoqatës, apo shkeljes së Statutit të Shoqatës.
- 13.3. Për suspendimin ose përjashtimin e një anëtarit vendos Këshilli Drejtues me miratimin e së paku dy të tretave të anëtarëve. Vendimi për suspendim ose përjashtim i dërgohet anëtarit në afat prej shtatë ditësh.
- 13.4. Personi i suspenduar ose përjashtuar ka të drejtë ankese. Ankesa i drejtohet Kuvendit, nëpërmjet kryetarit, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së vendimit për suspendim ose përjashtim. Kuvendi do ta shqyrtojë këtë ankese jo më vonë se 60 ditë pasi ankesa të jetë marrë nga kryetari. Vendimi i Kuvendit është përfundimtar.

## **IV. Organet e Shoqatës**

### **NENI 14.**

Shoqata e ka Kuvendin, kryetarin, Këshillin Drejtues, Seksionin e Mësimit të Mesëm të Lartë, dhe Seksionin e Mësimit të Mesëm të Ulët.

## **V. Kuvendi**

### **NENI 15.**

- 15.1. Kuvendi është organi më i lartë i Shoqatës.
- 15.2. Kuvendin e përbëjnë:
  - (a) Anëtarët e rregullt të cilët i plotësojnë kriteret e Nenit 11, paragrafi tre, pika (a) ose (b);
  - (d) Anëtarët e Nderit;
  - (c) Pesë përfaqësues të zgjedhur nga Seksioni i Mësimit të Mesëm të Lartë;
  - (d) Pesë përfaqësues të zgjedhur të Seksionit të Mësimit të Mesëm të Ulët.
- 15.3. Kuvendi e mban sesionin e rregullt një herë në vit.
- 15.4. Kuvendi mund të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm nëse këtë e kërkon kryetari i Shoqatës ose një e treta e anëtarëve të Kuvendit.
- 15.5. Në sesionet e jashtëzakonshme shqyrtohen vetëm çështjet për të cilat është kërkuar sesioni i jashtëzakonshëm.

- 15.6. Kuvendi i zhvillon punimet kur janë të pranishëm të paktën një e treta e anëtarëve të tij.
- 15.7. Mbledhjen e Kuvendit e thërret kryetari ose personi i autorizuar nga ai.
- 15.8. Anëtarët e Kuvendit thirren të paktën 15 ditë para se të mbahet secili sesion i Kuvendit.

## **VI. Kryetari**

### **NENI 16.**

- 16.1. Kryetari zgjedhet nga anëtarët e Kuvendit, me votim të fshehtë, nga lista me më shumë se një kandidat.
- 16.2. Fitues i zgjedhjeve nga paragrafi një i këtij neni është kandidati që merr jo më pak se 50%+1 të votave të anëtarëve të pranishëm.
- 16.3. Nëse në rrethin e parë te votimit asnjë kandidat nuk merr 50%+1 të votave të anëtarëve të pranishëm, brenda 24 orëve zhvillohet rrethi i dytë i votimit në të cilin votohet vetëm për kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë marrë numër më të madh ose të barabartë votash.
- 16.4. Fitues i rrethit të dytë të votimit është kandidati që merr numrin më të madh të votave. Në rast se dy ose më shumë kandidatë kanë numër të barabartë votash, fituesi shpallet sipas rendit alfabetik të mbiemrit, përkatësisht të emrit kur kandidatët kanë mbiemra të njëjtë.
- 16.5. Kandidati për kryetar duhet të jetë anëtar i Shoqatës dhe duhet të jetë doktor i shkencave matematike.
- 16.6. Kryetari ka mandat dyvjeçar, duke filluar nga dita e zgjedhjes. Askush nuk mund të zgjedhet kryetar më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.
- 16.7. Kryetari mund të shkarkohet në sesion të rregullt ose të jashtëzakonshëm të Kuvendit nëse për këtë votojnë të paktën dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit.
- 16.8. Kryetari mund të jep dorëheqje dhe për këtë duhet ta informojë Këshillin Drejtues brenda 24 orëve nga dhënja e dorëheqjes.
- 16.9. Kryetari i cili shkarkohet, jep dorëheqje, ose ka mbaruar një mandat dhe nuk rizgjedhet, nuk mund të rikandidohet brenda gjashtë vjetëve.
- 16.10. Në rastet e vdekjes, dorëheqjes, shkarkimit, ose pamundësisë së ushtrimit të detyrës për shkaqe shëndetësore, ligjore e të tjera, Këshilli Drejtues i Shoqatës e cakton ushtrues të detyrës së kryetarit një anëtar nga radhët e veta.
- 16.11. Në rastet si në paragrafin dhjetë të këtij neni, Kuvendi duhet ta zgjedh kryetarin e Shoqatës jo më vonë se gjashtë muaj nga data e caktimit të një personi si ushtrues i detyrës së kryetarit.

### **NENI 17.**

- 17.1. Kryetari e udhëheq Kuvendin dhe Këshillin Drejtues.
- 17.2. Kryetari siguron zbatimin e Statutit dhe akteve të tjera juridike të cilat i nxjerr Shoqata.
- 17.3. Kryetari, në emër të Shoqatës, nënshkruan marrëveshjet e nevojshme me organizmat, shoqatat, institucionet, dhe personat brenda dhe jashtë vendit.
- 17.4. Kryetari i Shoqatës raporton për aktivitetet dhe programet e Shoqatës në sesionin e rregullt vjetor të Kuvendit.

## VII. Këshilli Drejtues

### NENI 18.

- 18.1. Këshilli Drejtues (në tekstin e mëtejme vetëm “Këshilli”) është organ ekzekutiv i Shoqatës.
- 18.2. Kryetari i Shoqatës është ex officio kryetar i Këshillit, me të drejtë vote.
- 18.3. Jo të gjithë anëtarët e Këshillit janë të së njëjtës gjini.
- 18.4. Anëtarët e Këshillit zgjedhen nga Kuvendi, me vota të fshehta.
- 18.5. Mandati i anëtarëve të Këshillit është dyvjeçar.
- 18.6. I njëjti person nuk mund të zgjedhet anëtar i Këshillit më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.
- 18.7. Këshilli përbëhet nga:
  - (a) Një anëtar nga radhët e përfaqësuesëve të Seksionit të Mësimit të Mesëm të Ulët në Kuvend;
  - (b) Një anëtar nga radhët e përfaqësuesëve të Seksionit të Mësimit të Mesëm të Lartë në Kuvend;
  - (c) Katër anëtarë nga radhët e anëtarëve të tjerë të Kuvendit.
- 18.8. Kryetari i propozon gjashtë kandidatë për anëtarë të Këshillit dhe çdo dy anëtarë të Kuvendit kanë të drejtë ta propozojnë nga një kandidat tjetër për anëtar të Këshillit.
- 18.9. Renditja e kandidatëve në listën zgjedhore bëhet sipas alfabetit.
- 18.10. Nëse pas zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, sipas paragrafit shtatë të këtij neni, të gjithë anëtarët janë të së njëjtës gjini, Kuvendi do ta zgjedh me vota të fshehta edhe një anëtar tjetër të Këshillit në përputhje me paragrafin tre të këtij neni.
- 18.11. Anëtari i Këshillit mund të shkarkohet në sesion të rregullt ose të jashtëzakonshëm të Kuvendit nëse për këtë votojnë dy të tretat e anëtarëve të pranishëm në Kuvend.
- 18.12. Anëtari i Këshillit mund të jep dorëheqje dhe për këtë duhet ta njoftojë me shkrim kryetarin dhe Këshillin brenda 24 orëve.
- 18.13. Në rastet e vdekjes, dorëheqjes, shkarkimit, ose pamundësisë së ushtrimit të detyrës për shkaqe shëndetësore, ligjore e të tjera, Këshilli do ta emërojë një anëtar të Kuvendit që të shërbejë pjesën e mbetur të mandatit të anëtarit të Këshillit.

### NENI 19.

- 19.1. Kuorumi i domosdoshëm për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit është 50% + 1 i numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.
- 19.2. Vendimet në Këshill merren me shumicën e thjeshtë të votave.
- 19.3. Në rast të ndarjes së barabartë të votave, vendos vota e kryetarit.
- 19.4. Mbledhja e Këshillit mbahet me kërkesën e kryetarit ose me kërkesën e së paku tre anëtarëve të Këshillit.
- 19.5. Mbledhjen e Këshillit e thërret kryetari ose personi i autorizuar nga ai.
- 19.6. Anëtarët e Këshillit thirren së paku katër ditë para se të mbahet mbledhja e Këshillit.

### NENI 20.

Përgjegjësitë ndërmejt dy sesioneve të Kuvendit të cilat Statuti nuk i parasheh në mënyrë eksplicite se i takojnë ndonjë organi tjetër të Shoqatës mbesin përgjegjësi të Këshillit.

## **VIII. Seksionet e Mësimit të Mesëm të Lartë dhe të Ulët**

### **NENI 21.**

- 21.1. Anëtar i Seksionit të Mësimit të Mesëm të Lartë është anëtari i Shoqatës i cili ka dhënë ose jep mësim në ndonjë shkollë të mesme të lartë në Kosovë, si dhe kryetari i Shoqatës sipas detyrës zyrtare.
- 21.2. Anëtar i Seksionit të Mësimit të Mesëm të Ulët është anëtari i Shoqatës i cili ka dhënë ose jep mësim në ndonjë shkollë të mesme të ultë në Kosovë, si dhe kryetari i Shoqatës sipas detyrës zyrtare.
- 21.3. Zgjedhjet në Seksionet e Mësimit të Mesëm të Lartë dhe të Mesëm të Ulët mbahen çdo dy vjetë. Seksionet zgjedhin kryesuesin e Seksionit si dhe nga pesë anëtarë për Kuvendin e Shoqatës, me mandat dyvjeçar.
- 21.4. Mbledhjet e Seksioneve të Shoqatës mbahen të paktën një herë në vit.
- 21.5. Mbledhjet e Seksioneve të Shoqatës i udhëheqin kryesuesit e Seksioneve ose personat e autorizuar nga ata.
- 21.6. Mbledhjet e Seksioneve të Shoqatës i thërrasin kryesuesit e Seksioneve ose personat e autorizuar nga ata.
- 21.7. Anëtarët e Seksioneve të Shoqatës thirren të paktën 8 ditë para se të mbahen mbledhjet e Seksioneve.
- 21.8. Detyrat e Seksioneve përcaktohen me Rregulloren e Punës.

## **IX. Rregullorja e Punës**

### **NENI 22.**

- 22.1. Shoqata e ka Rregulloren e Punës (në tekstin e mëtejme vetëm “Rregullorja”).
- 22.2. Rregullorja është në përputhje të plotë me këtë Statut.
- 22.3. Rregulloren e miraton Këshilli Drejtues me dy të tretat e votave të anëtarëve të Këshillit.
- 22.4. Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores miratohen me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit.

## **X. Financat**

### **NENI 23.**

- 23.1. Fondi i Shoqatës përbëhet nga:
  - (a) Kontributi financiar vjetor i anëtarëve të rregullt (anëtarësia);
  - (b) Donacionet dhe dotacionet;
  - (c) Të hyrat e tjera në përputhje me ligjin.
- 23.2. Fondi i Shoqatës përdoret për të mbështetur qëllimet joprofitabile të Shoqatës dhe nuk përdoret për përfitime të veçanta individuale.
- 23.3. Anëtarët e Shoqatës nuk paguhen për pozitat zyrtare që i mbajnë në Shoqatë.
- 23.4. Kompensimet për personat e brendshëm apo të jashtëm, për projekte profesionale, bëhen në bazë të kontratës së veçantë.
- 23.5. Kompensimi për shpenzimet e udhëtimit në emër të Shoqatës është i lejuar. Secili kompensim arsyetohet me faturë dhe është objekt i verifikimit nga Këshilli. Kushte të tjera lidhur me kompensimin mund të precizohen me Rregulloren e Punës.

- 23.6. Personat të cilët i angazhon Shoqata në cilësinë e punëmarrësit i kompenson me pagë ose kontratë në vepër.
- 23.7. Të gjitha kompensimet materiale në emër të Shoqatës i miraton Këshilli Drejtues.
- 23.8. Mjetet e grumbulluara në fondin e Shoqatës mbahen në llogarinë bankare.

#### **NENI 24.**

- 24.1. Viti financiar i Shoqatës përputhet me vitin kalendarik.
- 24.2. Kryetari dhe Këshilli Drejtues paraqesin raporte vjetore financiare para Kuvendit në sesionin e rregullt, ose me kërkesë të një të tretës së anëtarëve të Kuvendit.

### **XI. Çmimet, medaljet dhe mirënjohjet**

#### **NENI 25.**

- 25.1. Shoqata mund të ndajë çmime, medalje dhe mirënjohje.
- 25.2. Çmimet, medaljet, dhe mirënjohjet mund t'u jepen personave dhe institucioneve të brendshme dhe të jashtme që kanë merita të veçanta për funksionimin e Shoqatës ose për shkencën e matematikës.
- 25.3. Propozimet nga paragrafi dy i këtij neni i bën Këshilli Drejtues, ndërsa vendimet i merr Kuvendi.

### **XII. Dispozitat e veçanta**

#### **NENI 26.**

- 26.1. Pjesëmarresit e Kuvendit Themelues të Shoqatës janë automatikisht anëtarë të Shoqatës.
- 26.2. Kuvendin Themelues, deri në zgjedhjen e kryetarit, e kryeson anëtari më i moshuar, i ndihmuar nga anëtari më i ri nga mosha.
- 26.3. Në qoftë se në Kuvendin Themelues nuk janë të pranishëm përfaqësuesit e seksioneve të Mësimi të Mesëm të Lartë dhe të Ulët, Kuvendi ka të drejtë të propozojë përfaqësuesit e këtyre Seksioneve në Këshillin Drejtues.

#### **NENI 27.**

- 27.1. Shoqata mund të shpërndalet me vendimin e dy të tretave të anëtarëve të Kuvendit.
- 27.2. Në rastin e shpërndarjes së Shoqatës, Kuvendi vendos për pasurinë e Shoqatës dhe për obligimet ligjore të saj.

### **XII. Dispozitat përfundimtare**

#### **NENI 28.**

- 28.1. Statutin e Shoqatës e miraton Kuvendi me dy të tretat e votave të anëtarëve të pranishëm. Me procedurë të njëjtë miratohen edhe ndryshimet dhe plotësimet e Statutit.
- 28.2. Interpretimet përfundimtare të Statutit i bën Kuvendi i Shoqatës.

**NENI 29.**

Statuti hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Kuvendi.

-----  
(Statuti u aprovua në Prishtinë, më 22 gusht 2008.)